



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 31 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 3228 prot., datë 13.06.2024, referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, për vënie në dispozicion të formularit të vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, që i përket gjyqtarës së Gjykatës Administrative të Apelit, {...}, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në zbatim të detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, çdo person që kandidon për t’u emëruar gjyqtar si dhe gjyqtarët të cilën kanë qenë në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbartin detyrimin ligjor për plotësimin e formularit të vetëdeklarimit nëpërmjet të cilit deklarojnë mosekzistencën e shkaqeve për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar. Referuar pikave 5 dhe 6 të nenit 5 të ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, këto vetëdeklarime mund të bëhen publike në çdo kohë dhe pa asnjë kufizim, si dhe kërkesa për marrjen e tyre nuk mund të refuzohet. Në respektim të këtij detyrimi, Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka publikuar formularëte vetëdeklarimit dhe mund të aksesohen në linkun <https://klgj.al/programi-i-transparences>.

Sa i përket kërkesës tuaj për vënie në dispozicion të formularit të vetëdeklarimit të gjyqtarës {...}, të njësuar me origjinalin, bashkëlidhur gjeni formularin e vetëdeklarimit të gjyqtarës në 7 (shtatë) fletë gjithsej.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!